



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21 regjistër (JR)
Datë 28.04.2022

Nr. 11 i vendimit
Datë 28.03.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 28.03.2023, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 21/2022 (JR), datë 28.04.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ervin Beqiri, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 516, datë 03.03.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pikat 1, 2 dhe 5, i Kushtetutës; Neni A, pika 1, neni C, pikat 3 dhe 5, neni D, pika 4, neni F, pikat 1, 2, 3 e 7, të Aneksit të Kushtetutës; Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 62, 63, 65 dhe 66, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 46, 47, 48 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Nenet 442, 443, 452 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili kërkoi pavlefshmërinë ose ndryshimin e vendimit nr. 516, datë 03.03.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ervin Beqiri, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
4. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklaram të rremë dhe; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ervin Beqiri, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 516, datë 03.03.2022.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 516, datë 03.03.2022, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, bazuar vetëm në përfundimet në lidhje me kriterin e pasurisë, ka

konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe se ai dhe huadhënësi nuk kanë burime të ligjshme, të cilat të përmbushin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Në përfundim, Komisioni, bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri.

III. Shkaqet e ankimit

Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, (në vijim Kolegji), me ankim kundër vendimit nr. 516, datë 03.03.2022, të Komisionit, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

7. Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit parashtron këto shkaqe ankimi:

7.1. Hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm dhe nuk janë administruar të gjithë dokumentet dhe provat e nevojshme para se të arrihej në konkluzionin përfundimtar. Vetëm pas një hetimi të plotë dhe pasi subjekti të kishte dhënë shpjegime, Komisioni duhet t'i kalonte barrën e provës për ato fakte që kanë rezultuar ndryshe nga sa ka deklaruar apo shpjeguar vetë subjekti.

7.2. Subjekti kundërshton vendimin e Komisionit për mospranimin e kërkesës së tij që të thërrasë dhe pyesë me cilësinë e dëshmitarit 12 shtetas, duke kërkuar nga Kolegji që të konstatojë pabazueshmërinë dhe paligjshmërinë e këtij vendimi.

7.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se provat dhe parashtrimet e tij nuk janë shqyrtuar dhe analizuar nga Komisioni dhe, përveç faktit se me *e-mail* i është njoftuar se provat janë administruar, nga Komisioni nuk është marrë asnjë vendim dhe nuk i është kthyer asnjë përgjigje.

7.4. Subjekti ankimon vendimin e ndërmjetëm nr. {***}, datë 10.02.2022, të Komisionit, për sa i përket shkakut ligjor për përjashtimin e komisioneres Pamela Qirko, si dhe për mospranimin e kërkesës për përjashtimin e dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues.

7.5. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi nr. 516, datë 03.03.2022, i Komisionit, i cili në shumicën e tij është bazuar në raportin e trupit gjykues të mëparshëm, është një vendim i marrë në kushtet e konfliktit të interesit dhe, si i tillë, është absolutisht i pavlefshëm. Subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur kërkesë Komisionit për të kryer një analizë të re financiare për shkaqe procedurale, ligjore dhe materiale, pasi analiza e mëparshme e kryer nga relatorja e parë, e cila sipas subjektit ka qenë në kushtet e konfliktit të plotë të interesit, nuk ka qenë e drejtë dhe ligjore dhe nuk ka pasqyruar në mënyrë të drejtë e të saktë faktet objekt hetimi. Komisioni, duke mos e rikryer analizën financiare dhe duke dalë me vendim, i ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, pasi subjekti ka qenë në kushtet e pamundësisë absolute për të debatuar dhe kundërshtuar qëndrimet dhe konkluzionet në lidhje me analizën financiare.

7.6. Sipas subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj konkluzioni i Komisionit se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për shkak se nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* pasuritë e personave të lidhur, prindërve dhe motrave.

7.7. Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kërkesat e kësaj dispozite.

7.8. Vendimi i Komisionit është i paarsyetuar nga ana ligjore dhe në kundërshtim me nenin 100 të Kodit të Procedurave Administrative dhe, rrjedhimisht, është i pavlefshëm. Në vendim janë përdorur shprehje dhe terminologji jo ligjore, të tilla si *duket se nuk është ashtu* ose *duket se është ashtu*, për sa më sipër nuk e llogaris/marr parasysht dhe është i mbushur me aludime e supozime nga të cilat nuk kuptohet cili është qëndrimi i Komisionit në rastin konkret.

8. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti parashtrohet si vijon.

8.1. *Për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 104,18 m², rruga “{***}”, Tiranë*

i) Subjekti vlerëson se është i gabuar konkluzioni i Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm dhe për mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, pasi nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat dhe mundësitë e kursimit të personave të tjerë të lidhur, prindërve dhe motrave të subjektit, si dhe huatë dhe të ardhurat e shtetasve M. M. dhe Th. dhe E. P..

ii) Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në deklaratat periodike pasuritë e prindërve ose të motrave, pavarësisht se ka bashkëjetuar me ta në të njëjtin trung familjar për një periudhë kohore. Sipas subjektit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049, detyrimin për deklarim e kanë vetëm bashkëshorti dhe fëmijët madhorë.

iii) Në bazë të ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit nuk kanë pasur për detyrë të deklaronin në deklaratën *vetting* huatë/dhurimet ose marrëdhëniet e tjera juridike të personave të lidhur me persona të tjerë, por vetëm kanë pasur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, sipas nenit 35/5 të ligjit nr. 84/2016.

iv) Në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI, subjektet e rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 9049, nuk kanë pasur për detyrë të deklaronin burimet e ligjshme të dhuruesve/huadhënësve të tyre, po vetëm të deklaronin me saktësi dhurimin, huanë ose çdo marrëdhënie tjetër juridike nga të cilat buronin interesa pasurore. Justifikimi i ligjshmërisë të burimit të krijimit të pasurive të dhuruesve/huadhënësve është një detyrim i cili rezulton vetëm në bazë të detyrimit kushtetues të përcaktuar nga Aneksi i Kushtetutës me titull “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

8.2. *Për analizën financiare të kryer në Komision*, subjekti parashtrohet në ankim se në raportin e hetimit të Komisionit të datës 13.01.2022 konstatohet se hetimi administrativo-financiar është bërë me gabime të shumta materiale, me përlllogaritje të gabuara të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe të bashkëshortes, të pabazuara në dokumente financiare e ligjore të administruara në dosjen e hetimit administrativ. Për personat e lidhur, prindërit dhe motrat e subjektit, në rezultatet e hetimit nuk janë llogaritur, në asnjë pikë të analizës financiare, të ardhurat dhe mundësitë për kursim.

8.3. Si konkluzion përfundimtar në kriterin e pasurisë, në analizë të të gjithë fakteve dhe provave të administruara gjatë procesit administrativ si nga ana e Komisionit dhe ato të paraqitura prej tij,

si dhe të analizës së paraqitur në ankim, në zbatim edhe të parimit të proporcionalitetit, subjekti i rivlerësimit vlerëson se përmbush standardin kushtetues e ligjor për të provuar në mënyrë bindëse burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, gjendet në kushtet e parashikuara edhe nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka vetëm disa pasaktësi në deklaram, të cilat nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, për shkak se deklaramet e pasakta të konstatuara nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë dhe për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

9. Lidhur me shkaqet e paraqitura në ankim, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj në datën 23.03.2023, parashtrime shtesë, si dhe kërkoi administrimin si prova të reja në seancë gjyqësore të procesverbaleve të ILDKPKI-së të datave 17.02.2012, 09.04.2014 dhe 04.03.2016, vënë në dispozicion subjektit pas kërkesës së tij, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.12.2022, të ILDKPKI-së.

Në shqyrtim të kësaj kërkesë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se tri procesverbalet e sipërpërmendura të ILDKPKI-së janë pjesë e akteve në fashikujt e Komisionit dhe i janë dërguar Komisionit nga ky institucion me shkresat nr. {***} prot., datë 20.10.2021, dhe nr. {***} prot., datë 09.11.2021. Këto procesverbale i janë bërë të njohura subjektit të rivlerësimit kur ai është njoftuar për t’u njohur me dosjen në datën 13.01.2022, njoftim të cilin e ka konfirmuar me e-mail në datën 14.01.2022. Subjekti, bashkë me prapësimet përfundimtare, ka dorëzuar në Komision edhe një kopje të procesverbalit të datës 17.02.2012, të ILDKPKI-së. Gjithashtu, konstatohet se në rezultatet e hetimit dërguar subjektit, Komisioni ka referuar dhe dy nga procesverbalet e mësipërme (të viteve 2012, 2016), të dërguara nga ILDKPKI-ja, pra, edhe në këtë moment procedural subjekti ka qenë i njohur për disponimin nga Komisioni të këtyre akteve. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi të mos pranojë kërkesën e subjektit për marrje si prova të reja të procesverbaleve të ILDKPKI-së, pasi këto akte janë administruar në dosjen e Komisionit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Aspekte procedurale

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

10. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

11. Ankuesi Ervin Beqiri, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtuar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit.
12. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 15-ditor¹ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të pretendimeve të paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet shtesë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit dhe vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i pretendimeve të subjektit mbi aspektet procedurale dhe procesin e rregullt

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm, nuk janë administruar të gjithë dokumentet dhe provat e nevojshme para se të arrihej në konkluzionin përfundimtar, dhe se i është dërguar vetëm një pyetësor shtesë përveç pyetësorit standard. Sipas subjektit Komisioni, vetëm pas një hetimi të plotë dhe pasi subjekti të kishte dhënë shpjegime, duhet t’i kalonte barrën e provës për ato fakte që kanë rezultuar ndryshe nga sa ka deklaruar apo shpjeguar vetë subjekti.

14.1. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk jep të dhëna konkrete lidhur me cilat fakte për të cilat i ka kaluar barra e provës nuk ka pasur dijeni, si dhe përse e konsideron të paplotë hetimin e kryer nga Komisioni. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit i ngre këto pretendime vetëm si çështje, por pa i trajtuar ato, si dhe pa i lidhur me situatën apo veprimin konkret gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision. Për sa i përket momentit të kalimit të barrës së provës, trupi gjykues sjell në vëmendje se dispozitat e ligjit nr. 84/2016 e përcaktojnë qartë se pasi Komisioni ka hetuar dhe vlerësuar të gjithë faktet dhe rrethanat dhe arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës dhe duhet të paraqesë prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Gjithashtu,

¹ Sipas akteve të administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 516, datë 03.03.2022, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 07.04.2022, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 08.04.2022. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 22.04.2022 dhe protokolluar nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 22.04.2022.

trupi gjykues vëren se në kundërshtim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, fakti se i është dërguar vetëm një pyetësor shtesë nuk është tregues për një hetim jo të plotë dhe të gjithanshëm nga ana e Komisionit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit mbeten në nivel deklarativ dhe janë të pambështetura në prova dhe në ligj.

15. Subjekti kundërshton vendimin e Komisionit për mospranimin e kërkesës së tij që të thërrasë dhe pyesë me cilësinë e dëshmitarit 12 shtetas, duke kërkuar nga Kolegji që të konstatojë pabazueshmërinë dhe paligjshmërinë e këtij vendimi dhe të pyesë me cilësinë e dëshmitarit shtetasit V. T., L. T., M. M., Th. P. e E. P., pasi marrëdhëniet juridike e faktike me këta persona janë vënë në dyshim nga Komisioni. Për sa i takon këtij pretendimi, nga aktet në fashikujt e Komisionit, konstatohet se në vendimin nr. {***}, datë 09.02.2022, të Komisionit është arsyetuar se përse janë rrëzuar kërkesat e subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve. Konkretisht, në këtë vendim, Komisioni është shprehur se pasi është administruar i gjithë dokumentacioni ligjor lidhur me transaksionet e kryera nga këta shtetas, në asnjë moment nuk është vënë në dyshim vërtetësia e nënshkrimit të tyre. Pavarësisht pretendimeve të subjektit, trupi gjykues vëren se argumentimi i dhënë në Komision për mospranimin e kërkesës rezulton të jetë sqarues lidhur me arsyet e vendimmarrjes, brenda diskrecionit të Komisionit për të vlerësuar marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve në kuadër të parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë pretendimet dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit vlerësohen të pabazuara.
16. Trupi gjykues vlerëson si të pabazuara në fakte pretendimet e subjektit të rivlerësimit se provat dhe parashtrimet e tij nuk janë shqyrtuar dhe analizuar nga Komisioni, dhe përveç faktit se me *e-mail* i është njoftuar se provat janë administruar, nga Komisioni nuk është marrë asnjë vendim dhe nuk i është kthyer asnjë përgjigje subjektit. Nga përmbajtja e vendimit nr. 516, datë 03.03.2022, vërehet se në tërësinë e tij ky vendim përmban analizën e akteve dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti përgjatë hetimit administrativ. Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella prej subjektit të rivlerësimit, të atyre të cilat janë çmuar prej tij dhe me ndikimin apo efektin që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas së cilit: *“Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ”*. Në vendim Komisioni është shprehur se: *“185. Në përfundim të vlerësimit për kriterin e pasurisë, pas vlerësimit të rezultateve të hetimit në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të barrës së provës, si dhe vlerësimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë hetimit dhe akteve të administruara në vijim të barrës së provës dhe dëgjimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues i Komisionit arriti në konkluzionin se provat për kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për një pjesë të tyre”*. Në referencë edhe të jurisprudencës së Kolegjit² vlerësohet se fakti që këto akte e prova të subjektit Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej tij nuk do të thotë se ka munguar vlerësimi lidhur me to, në kuptim të garantimit të elementeve të procesit të rregullt ligjor.

² Shih vendimet nr. 5/2019(JR), nr. 13/2019 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 26/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR) dhe nr. 19/2021 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

17. Subjekti i rivlerësimit ankimon vendimin e ndërmjetëm nr. {***}, datë 10.02.2022, të Komisionit, për sa i përket shkakut ligjor për përjashtimin e komisioneres Pamela Qirko, si dhe për mospranimin e kërkesës për përjashtimin e dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues. Sipas subjektit të rivlerësimit, komisionerja e përjashtuar ka qenë në kushtet e konfliktit të plotë të interesit dhe Komisioni duhet të kishte përjashtuar dhe dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues, për shkak se kanë qenë në favorizim dhe nën ndikimin e komisioneres së përjashtuar. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson se:

17.1. Subjekti, me kërkesën e datës 09.02.2022, drejtuar Komisionit, ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, duke paraqitur si shkak përjashtimi faktin se ka konstatuar se relatorja, znj. Pamela Qirko, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, i cili në vitet 2005-2007, si avokat, ka qenë përfaqësues ligjor i bashkëshortit të saj M. Q., me prokurë të posaçme, në një proces civil me objekt “padi pune” dhe në një çështje hetimore me objekt “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”.

17.2. Komisioni, pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues të caktuar për rivlerësimin e tij, me vendimin nr. {***}, datë 10.02.2022, ka vendosur: “1. Pranimin e pjesëm të kërkesës së subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri, për përjashtimin e komisioneres Pamela Qirko, nga shqyrtimi i mëtejshëm i dosjes së rivlerësimit, si kërkesë e bazuar në prova dhe në ligj. 2. Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e anëtarëve të tjerë të trupit gjykues”. Komisioni ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, për përjashtimin e komisioneres Pamela Qirko, me arsyetimin se në bazë të fakteve të dala nga provat e administruara janë evidentuar rrethana të tilla që në dukje shfaqin perceptimin para subjektit dhe publikut se përmbushen kërkesat e shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 3 të ligjit nr. 9367 “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Ky vendim i arsyetuar i është njoftuar subjektit në datën 14.02.2022.

17.3. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit pretendon se për komisioneren që është përjashtuar në këtë vendim plotësohen kushtet e konfliktit të plotë të interesit dhe jo të konfliktit të interesit në dukje, pasi komisionerja ka qenë në dijeni të faktit që subjekti ka qenë avokat i bashkëshortit të saj, aq më tepër që gjyqi zhvillohej kundër të njëjtit punëmarrës ku dhe ajo ishte e punësuar në kohën që është zhvilluar gjykimi, si dhe ka qenë në dijeni të plotë të konfliktit të subjektit me bashkëshortin e saj, me të cilin bashkëjetonte në atë kohë. Gjithashtu, subjekti pretendon se duhet të ishin përjashtuar dhe dy komisionerët e tjerë të Komisionit, pasi këta komisionerë me vendimet dhe me mosveprimet e tyre kanë qenë në favorizim të hapur të qëndrimit të komisioneres tjetër të përjashtuar, pasi janë gjithmonë bashkë në të njëjtin trup gjykues, si dhe janë nën ndikimin e saj të drejtpërdrejtë si kryetare e Komisionit.

17.4. Lidhur me sa pretendon subjekti, për dijeninë për konfliktin e interesit të komisioneres Pamela Qirko, trupi gjykues konstaton se situata të cilës ai i referohet ka ndodhur në vitet 2005-2007, gjatë kohës që ai ushtronte aktivitetin si avokat. Trupi gjykues vëren se vetë subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni për këtë situatë konflikti i interesit që në fillim të procesit të rivlerësimit dhe duhet ta deklaronte atë menjëherë pas njohjes me përbërjen e trupit gjykues, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të deklaruar konfliktin e interesit, sipas e-mail-it dërguar subjektit në datën 27.02.2020. Subjekti e pretendon pasjen dijeni për situatën e konfliktit të interesit vetëm nga ana e komisioneres duke kërkuar përgjegjësinë e saj për këtë situatë, ndërkohë që dhe ai vetë, duke qenë direkt i përfshirë në një marrëdhënie kontraktore me bashkëshortin e komisioneres, duhet ta evidentonte dhe ta deklaronte këtë situatë që në fillim të procesit. Subjekti nuk jep asnjë

argument bindës se përse ka pritur deri në datën 09.02.2022 (dy vjet nga njohja me përbërjen e trupit gjykues) dhe vetëm pas thirrjes për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike ka vënë në dijeni Komisionin për konfliktin e interesit me një nga komisionerët, duke kërkuar dhe përjashtimin e gjithë trupit gjykues. Nga aktet në fashikuj, rezulton se Komisioni, me një trup tjetër gjykues, më datë 10.02.2022, ka shqyrtuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe në përfundim ka marrë vendim për përjashtimin e komisioneres Pamela Qirko nga trupi gjykues, duke pranuar kërkesën e subjektit dhe duke i dhënë në këtë mënyrë zgjidhje situatës së konfliktit të interesit dhe çdo pretendimi të subjektit në këtë drejtim. Vendimi i arsytuar nr. {***}, datë 10.02.2022, i Komisionit i është dërguar subjektit të rivlerësimit, në rrugë elektronike, në datë 14.02.2022. Në vështrim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit, duke mos deklaruar që në fillim të nisjes së procesit të rivlerësimit konfliktin e interesit me komisioneren/relatoren e trupit gjykues dhe duke e ngritur këtë pretendim vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit, si dhe duke e pretenduar përgjegjësinë për deklarimin e konfliktit të interesit vetëm nga komisionerja, është një sjellje që krijon dyshime për veprime të paramenduara të subjektit në drejtim të zvarritjes së procesit.

17.5. Ndërkohë, për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se dhe dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues, për të cilët ka kërkuar përjashtimin, kanë qenë të lidhur dhe kanë vepruar nën ndikimin e komisioneres së përjashtuar, trupi gjykues konstaton se është një pretendim i pambështetur dhe i pabazuar në fakte, pasi nuk ka asnjë të dhënë konkrete nga subjekti dhe, si i tillë, nuk qëndron.

18. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi nr. 516, datë 03.03.2022, i Komisionit, i cili në shumicën e tij është bazuar në raportin e trupit gjykues të mëparshëm, është një vendim i marrë në kushtet e konfliktit të interesit dhe, si i tillë, është absolutisht i pavlefshëm. Subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur disa kërkesa Komisionit për pavlefshmëri të procedurave në kuadër të procesit të hetimit, si dhe për kryerjen e një analizë të re financiare për shkaqe procedurale, ligjore dhe materiale, pasi analiza e mëparshme e kryer nga relatorja e parë, e cila sipas subjektit ka qenë në kushtet e konfliktit të plotë të interesit, nuk ka qenë e drejtë dhe ligjore dhe nuk ka pasqyruar në mënyrë të drejtë e të saktë faktet objekt hetimi. Komisioni, duke mos e rikryer analizën financiare dhe duke dalë me vendim i ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, pasi subjekti ka qenë në kushtet e pamundësisë absolute për të debatuar dhe kundërshtuar qëndrimet dhe konkluzionet në lidhje me analizën financiare. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë fazës së hetimit nuk është njoftuar lidhur me vendimmarrjen e trupit gjykues për kërkesat e paraqitura prej tij.

19. Trupi gjykues konstaton se pretendimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit i lidh me këto rrethana:

19.1. Pas vendimit të ndërmjetëm të Komisionit për përjashtimin e komisioneres Pamela Qirko, në datën 15.02.2022, subjekti ka paraqitur kërkesë në Komision ku ka kërkuar që të konstatohet pavlefshmëria dhe të anulohen procedurat administrative të kryera në kuadër të hetimit administrativ nga trupi gjykues i mëparshëm. Në ankim, subjekti parashtron se këtë kërkesë e ka bazuar në faktin dhe në bindjen se procedura administrative e ndjekur dhe e zbatuar gjatë hetimit administrativ ka qenë e njëanshme, e paragjykuar dhe në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti parashtron në ankim se për këtë kërkesë nuk është marrë asnjë vendim i ndërmjetëm që t'i jetë njoftuar zyrtarisht dhe nuk ka pasur asnjë përgjigje zyrtare nga Komisioni për kërkesën e tij. Në seancën dëgjimore të datës 01.03.2022 është paraqitur i njëjti raport hetimi për të cilin subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pavlefshmërinë.

19.2. Me kërkesën e datës 23.02.2022, subjekti i ka paraqitur Komisionit një kërkesë tjetër me shkrim për rikryerje të analizës financiare për shkaqe procedurale, ligjore dhe materiale, pasi, sipas tij, analiza e mëparshme e kryer nga relatorja e parë, e cila ka qenë në kushtet e konfliktit të plotë të interesit, nuk ka qenë e drejtë dhe ligjore dhe nuk ka pasqyruar në mënyrë të drejtë e të saktë faktet objekt hetimi. Edhe për këtë kërkesë subjekti pretendon se nuk ka pasur njoftim nëse është marrë vendim i ndërmjetëm. Vetëm në vendimin përfundimtar subjekti është njohur me arsyetimin se kërkesa e tij për rikryerjen e një analize të re financiare do të vlerësohej gjatë bisedimeve në dhomë këshillimi, pasi të dëgjoheshin edhe shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore. Fakti se në vendimin përfundimtar ka një pjesë arsyetuese, sipas subjektit, nuk do të thotë se është një vendim ligjor, pasi ky arsyetim është dhënë në kushtet e një vendimi të marrë paraprakisht dhe në kushtet e pabarazisë së armëve.

20. Subjektit i rivlerësimit pretendon se rezultatet e hetimit dhe analiza e mëparshme financiare janë kryer në kushtet e konfliktit të interesit dhe janë të pavlefshme, dhe se Komisioni duhet të anulonte veprimet e mëparshme në kuadër të hetimit administrativ dhe të kryente një analizë të re financiare pas zëvendësimit të relatores. Për sa u përket këtyre pretendimeve, nga verifikimi i akteve në fashikuj, trupi gjykues konstaton se Komisioni, pas vendimit për përjashtimin e relatores Pamela Qirko, ka njoftuar në datën 11.02.2022 subjektin e rivlerësimit se anëtare zëvendësuese dhe relatore e çështjes do të jetë komisionerja Valbona Sanxhaktari. Në datën 17.02.2022, subjekti i rivlerësimit është njoftuar të paraqesë përsëri në Komision shpjegimet dhe provat. Vetë subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit e ka përmendur faktin se në datën 17.02.2022 nga ana e relatores së re të trupit gjykues i është kërkuar që brenda datës 21.02.2022 të riparaqesë në Komision shpjegimet bashkë me provat shkresore, si dhe analizën financiare të përgatitur prej tij. Me e-mail-in e datës 25.02.2022, Komisioni ka informuar subjektin se anëtari zëvendësues, pasi është njohur me dosjen e hetimit dhe rezultatet e hetimit, ka çmuar se është dakord me to dhe nuk ka kërkuar veprime të tjera shtesë, duke vlerësuar të shkojë në seancë dëgjimore për të dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit. Nga përmbajtja e komunikimeve të mësipërme, si dhe nga verifikimi i akteve korresponduese, trupi gjykues vëren se në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit relatorja e re e çështjes ka marrë kohën e nevojshme të njihet me dosjen dhe rezultatet e hetimit dhe ka vlerësuar se nuk ka pasur nevojë për hetime shtesë, duke u qëndruar rezultateve të hetimit që i janë dërguar më parë subjektit, si dhe duke rezervuar të drejtën të shprehet më gjerë, pasi të ketë dëgjuar dhe vetë subjektin në seancë dëgjimore. Ky qëndrim i relatores së re të çështjes gjendet i pasqyruar dhe në vendimin nr. {***}, datë 16.02.2022, të trupit gjykues të Komisionit, dispozitivi i të cilit i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me e-mail-in e datës 25.02.2022. Në vendimin përfundimtar, Komisioni, lidhur me kërkesat e subjektit të rivlerësimit dhe vendimmarrjen lidhur me to, shprehet: *“17. Në datën 15.02.2022 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një kërkesë për pavlefshmëri të hetimeve dhe rezultatit të hetimit të realizuar nga trupi gjykues i mëparshëm. Trupi gjykues ka vlerësuar kërkesën në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, duke vendosur mospranimin e saj, mbështetur edhe në arsyetimin se anëtari zëvendësues i futur rishtazi në këtë proces, pasi është njohur me dosjen e hetimit dhe rezultatet e hetimit, ka çmuar se është dakord me to dhe nuk kërkon veprime të tjera shtesë, duke vlerësuar të shkojë në seancë dëgjimore për të dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit [...]. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se mbeten të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pavlefshmëri të rezultateve të hetimit dhe të analizës financiare të Komisionit, për shkak se janë kryer nga relatorja e mëparshme dhe në kushtet e konfliktit të interesit.*

21. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për mosnjohimin e vendimmarrjes për kërkesat e tij për pavlefshmëri të procedurave në kuadër të procesit të hetimit, dhe se pas njohjes pranë Kolegjit me aktet në dosjen e Komisionit, ka konstatuar disa vendime të ndërmjetme të Komisionit, të ndodhura në fashikullin 16, për të cilat nuk ka pasur dijeni, duke pretenduar se këto vendime janë bërë pas paraqitjes prej tij të ankimit ndaj vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se:

21.1. Nga aktet në fashikullin e sipërcituar të Komisionit, rezulton se subjekti u referohet vendimeve të ndërmjetme nr. {***}, {***}, {***} dhe {***}, të Komisionit. Me vendimin nr. {***}, datë 16.02.2022, Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit të datës 15.02.2022, për konstatimin e pavlefshmërisë së procedurave dhe veprimeve të kryera në kuadër të hetimit administrativ, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Nga aktet në fashikuj rezulton se me *e-mail*-in e datës 25.02.2022, Komisioni ka informuar subjektin se anëtari zëvendësues, pasi është njohur me dosjen e hetimit dhe rezultatet e hetimit ka çmuar se është dakord me to dhe nuk ka kërkuar veprime të tjera shtesë, duke vlerësuar të shkojë në seancë dëgjimore për të dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit.

21.2. Me vendimin nr. {***}, datë 24.02.2022, Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit që mban datën 23.02.2022, për rikryerjen e analizës financiare, ka vendosur mospranimin e kërkesës deri në këtë fazë të hetimit. Me *e-mail*-in e datës 25.02.2022, subjekti është njoftuar se deri në këtë fazë nuk është pranuar kërkesa për riçeljen e hetimit dhe se trupi gjykues, pasi të dëgjojë subjektin në seancë dëgjimore dhe të vlerësojë shpjegimet, do të shprehet mbi riçeljen e hetimit dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, përfshirë edhe analizën financiare.

21.3. Me vendimin nr. {***}, datë 25.02.2022, Komisioni ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 1.03.2022. Për këtë vendim, subjekti është njoftuar me *e-mail*, në datën 25.02.2022.

21.4. Me vendimin nr. {***}, datë 01.03.2022, Komisioni, pas kërkesës së paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, për kryerjen e një analize të re financiare dhe për hapjen e hetimit administrativ për të tri kriteret e rivlerësimit, është tërhequr në dhomë këshillimi dhe ka vendosur të administrojë dy kërkesat e subjektit dhe t'i diskutojë ato gjatë procesit të diskutimeve për vendimmarrje. Siç rezulton nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 01.03.2022, ky vendim i është njoftuar subjekti me rifillimin e seancës.

22. Në përfundim, lidhur me pretendimet e subjekti se nuk ka pasur dijeni për vendimet e ndërmjetme të Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti është njoftuar me *e-mail*, sipas parashikimeve të nenit 62 të ligjit nr. 84/2016, dhe se ka marrë dijeni për vendimmarrjen e Komisionit lidhur me kërkesat e tij, pavarësisht se nuk i janë dërguar vendimet e arsyetuara, argumentimi i të cilave është bërë pjesë e vendimit përfundimtar të Komisionit.

23. Trupi gjykues çmon se janë të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se është cenuar parimi i kontradiktoritetit, pasi subjekti ka qenë në kushtet e pamundësisë absolute për të debatuar dhe kundërshtuar qëndrimet dhe konkluzionet në lidhje me analizën financiare. Bazuar në aktet në fashikuj, trupi gjykues konstaton se gjatë kryerjes së hetimit administrativ Komisioni ka pasur komunikim të vazhdueshëm me subjektin, të cilit i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegime dhe prova, fillimisht në përgjigje të pyetësorëve, më pas, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës dhe, më tej, me shpjegimet dhe sqarimet e dhëna në

seancat dëgjimore të zhvilluara në Komision. Në datën 13.01.2022, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimeve dhe i është kaluar barra e provës lidhur me to, sikundër dhe i janë bërë me dije të drejtat e tij në procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve në ligjin nr. 84/2016. Në datën 23.01.2022, subjekti ka paraqitur një kërkesë për administrimin e provave të reja në kuadër të hetimit administrativ, duke paraqitur dhe kundërshtimet e tij lidhur me analizën financiare të Komisionit. Gjithashtu, konstatohet se dhe në kërkesën e datës 09.02.2022, për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përsëri kundërshtimet e tij për analizën financiare. Në datën 7.02.2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrimet, si dhe provat në përgjigje të rezultateve të hetimit. Gjithashtu, nga aktet rezulton se në seancën dëgjimore të datës 1.3.2022, subjekti i rivlerësimit i paraqiti dy kërkesa trupit gjykues, duke kërkuar: “1. Kryerjen e një analize të re financiare në kuadër të hetimit administrativ në kriterin e pasurisë. 2. Konstatimin e nivelit të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe hapjen e hetimit administrativ për të tri kriteret e rivlerësimit”. Trupi gjykues i Komisionit, i tërhequr në dhomë këshillimi, vendosi të administrojë të dy kërkesat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, t'i diskutojë dhe shqyrtojë gjatë procesit të diskutimeve për vendimmarrjen përfundimtare.

24. Në vështrim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues vlerëson si të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për pavlefshmërinë e vendimit nr. 516, datë 03.03.2022, për shkak të konfliktit të interesit të relatores së mëparshme, si dhe për moskryerjen nga Komisioni të një analize të re financiare. Trupi gjykues konstaton se nuk vërtetohen rrethanat e parashikuara nga neni 108³, shkronja “b” të Kodit të Procedurave Administrative, për pavlefshmërinë e aktit administrativ. Në kushtet kur Komisioni ka pranuar pjesërisht kërkesën e subjektit për përjashtimin e trupit gjykues, duke zëvendësuar një prej anëtarëve për të cilin subjekti ka pretenduar konfliktin e interesit, ka vlerësuar çdo kërkesë dhe pretendim të subjektit të rivlerësimit, si në fazën e hetimit, ashtu dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore, duke i dhënë mundësi të shprehet për gjetjet e Komisionit, midis tyre dhe për analizën financiare, pretendimet e subjektit janë të pabazuara në fakte dhe në ligj dhe nuk mund të përbëjnë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.
25. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar nga ana ligjore dhe në kundërshtim me nenin 100 të Kodit të Procedurave Administrative dhe, rrjedhimisht, është i pavlefshëm, trupi gjykues konstaton se ky vendim, në përputhje me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, përmban bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe caktimin e masës disiplinore. Në vendim është bërë një analizë e provave, të cilat janë përdorur për vlerësimin e pasurisë, për secilën pasuri apo të ardhur të hetuar, janë marrë në konsideratë shpjegimet, provat dhe pretendimet e subjektit, duke i cituar ato herë pas here, deklaratat e personave të lidhur me të, si dhe janë dhënë shpjegimet për mospranimin e kërkimit të provave. Për sa i përket pretendimit tjetër të subjektit se në rezultatet e hetimit dhe në vendim janë përdorur shprehje dhe terminologji jo ligjore, të tilla si *duket se nuk është ashtu ose duket se është ashtu, për sa më sipër nuk e llogaris/marr parasysht*, nga të cilat nuk kuptohet cili është qëndrimi i

³ Neni 108: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj”.

Komisionit, nga kontrolli i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, objekt shqyrtimi në Kolegj, konstatohet se këto shprehje nuk janë përdorur nga Komisioni në arsyetimin e vendimit dhe, për rrjedhojë, këto pretendime të subjektit rezultojnë të pabazuara.

26. Subjekti pretendon se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kërkesat e nenit 61/3 të ligjit 84/2016, dhe në kushtet kur është hetuar për kriterin e pasurisë, subjekti nuk mund të jetë njëkohësisht dhe në shkelje të kriteve për kontrollin e figurës, siç e kërkon ky nen. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se tashmë është krijuar një jurisprudencë e konsoliduar⁴ në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) është i pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Kolegji ka vlerësuar se nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar në ligj.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

27. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon të shqyrtojë fillimisht pretendimet e subjektit lidhur me detyrimin për deklarin në deklaratën *vetting* të prindërve dhe motrave të tij.
28. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është i pabazuar në ligj konkluzioni i Komisionit se ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për shkak se nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* pasuritë e personave të lidhur, prindërve dhe motrave. Sipas subjektit të rivlerësimit ky konkluzion i Komisionit është i pabazuar në ligj, konkretisht në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në praktikën e deritanishme të Komisionit dhe Kolegjit. Subjekti pretendon se në momentin e plotësimit dhe të dorëzimit të deklaratës *vetting* që ka qenë data 28.1.2017, në certifikatën e gjendjes civile ka qenë në trung familjar të përbërë prej tij bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët e mitur.
29. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit konstatohet se Komisioni në vendim është shprehur se: *“129. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte lidhur me familjarët e tij (babai, nëna dhe motrat), në cilësinë e personave të lidhur me të, gjë të cilën duket se ai e ka shmangur me arsyetimin se ishte ndarë nga trangu familjar pas datës 17.10.2016 (deri në atë kohë ka qenë në përbërje familjare së bashku me prindërit e tij dhe motrat). Pasuria e krijuar prej tij në vitin 2013 ka qenë më së shumti e mbështetur financiarisht nga familjarët e tij, të cilët duhet të deklaronin në cilësinë e personave të lidhur dhe jo në cilësinë e personave të tjerë të lidhur. Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se edhe ata kanë pasur pasuri të krijuara, ndër vite, si likuiditete bankare. Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shmangur nga deklarimi *vetting* pasuritë e familjarëve të tij dhe se në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kishte detyrimin për deklarin, duke bërë kështu deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*”*.
30. Sipas akteve në fashikuj, nga shkresa nr. {***}, datë 10.11.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për informacion mbi përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 08.10.2013-08.10.2016, rezulton se në datën 08.10.2016,

⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 9 (JR), datë 24.10.2018; nr.7 (JR), datë 05.04.2019; nr.15 (JR), datë 17.07.2019, nr. 28 (JR), datë 30.10.2019 etj.

subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit, motrën dhe mbesën, së bashku me bashkëshorten dhe dy vajzat e tij.

30.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje se bazuar në parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Sipas pikës 13, të nenit 3, të po këtij ligji “*person i lidhur*” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit.

31. Trupi gjykues konstaton nga aktet se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në datën 08.10.2016⁵, subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit dhe motrat. Për efekt të këtij ligji, sipas dispozitave të cituara më sipër, prindërit dhe motrat e subjektit të rivlerësimit, për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë familjare, konsiderohen persona të lidhur që kanë pasur detyrimin për të paraqitur deklaratën e pasurisë *vetting* bashkë me gjithë dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre. Ndarja e subjektit të rivlerësimit nga trugu familjar, disa ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016⁶, nuk i ka përjashtuar nga përgjegjësia ligjore për deklarimin e pasurive në deklaratën *vetting* prindërit dhe motrat, të cilët kanë qenë pjesë e certifikatës familjare në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se është qenia në certifikatën familjare për gjithë periudhën e rivlerësimit që përcakton rrethin e personave të lidhur që duhet të deklarojnë, në kuptim të nenit 3, pika 13 dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka shmangur detyrimin për deklarim të pasurisë dhe të interesave privatë të personave të lidhur, mungesa e deklarimit të të cilëve ka pamundësuar Komisionin në drejtim të hetimit të pasurive të tyre. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit, i cili ka ndryshuar certifikatën familjare disa ditë pasi ka hyrë në fuqi ligji nr. 84/2016, si dhe pas daljes së Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, tregon për një veprim të paramenduar prej tij për shmangien nga deklarimi në procesin e rivlerësimit të familjarëve të tij. Duke i qëndruar pretendimit se prindërit dhe motrat e tij nuk janë persona të lidhur me të, subjekti i rivlerësimit vetëm pas kërkesave të Komisionit dhe pas kalimit të barrës së provës ka paraqitur deklaratat e pasurisë *vetting* të personave të lidhur (prindërve dhe motrave), si dhe dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me interesat pasurore të tyre.

32. Në vlerësimin përfundimtar, trupi gjykues konkludon se është i bazuar në ligj qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*, pasi ka shmangur nga deklarimi pasuritë e familjarëve të tij, të cilët, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, kishin detyrimin që të deklaronin interesat pasurore në kuadër të procesit të rivlerësimit.

⁵ Ligji nr. 84/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016.

⁶ Sipas akteve në fashikuj, në datën 17.10.2016.

- *Për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 104,18 m², të ndodhur rrugën “{***}”, Tiranë*

33. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, pas analizës së kryer mbi krijimin e kësaj pasurie, ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*, ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 945.914 (nëntëqind e dyzetë e pesë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) lekë për pagesën e kështit të parë dhe në vlerën (-) 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë për pagesën e kështit të dytë, të dyja këto pagesa të realizuara gjatë vitit 2013. Kjo situatë e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
34. Lidhur me vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

34.1. Lidhur me pagesën e kështit të parë të apartamentit

34.1.1. Është i gabuar konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën (-) 687.991 lekë, pasi nuk janë marrë parasysh burime të ligjshme të të ardhurave dhe mundësitë e kursimit të personave të tjerë të lidhur, prindërve dhe motrave të subjektit, si dhe të ardhurat dhe mundësitë për kursim të shtetasve M. M. dhe Th. dhe E. P.. Konkretisht, në analizën e të ardhurave të prindërve nuk është përfshirë shuma 1.500.000 lekë përfituar nga shitja e një pasurie të paluajtshme të llojit apartament. Komisioni bazuar edhe në konstatimin se *prindërit e subjektit kanë krijuar menjëherë pas shitjes së pasurisë apartament në Fier, një pasuri të paluajtshme tjetër, në të njëjtin vit dhe në një vlerë disa herë më shumë [...]*, nuk e ka përfshirë në analizë këtë vlerë, pasi apartamenti, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 03.06.2020, megjithëse është shitur prej prindërve të subjektit, vazhdon të jetë i regjistruar në pronësinë e tyre.

34.1.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në deklaratat periodike pasuritë e prindërve ose të motrave, pavarësisht se ka bashkëjetuar me ta në të njëjtin trung familjar për një periudhë kohore. Sipas subjektit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049, detyrimin për deklaram e kanë vetëm bashkëshorti dhe fëmijët madhorë. Për këtë arsye, subjekti pretendon se nuk ka deklaruar asnjëherë sa ka qenë gjendja *cash* e kursimeve të prindërve para dhe gjatë ushtrimit të detyrës. Deklarimi prej subjektit në DPV-në 2009 i shumës *cash* prej 900.000 lekësh dhe pjesa takuese është 80% dhe sqarimi në pyetësonin nr. 2 se pjesa 20% ose shuma 180.000 lekë ishte kursim i babait nuk duhet të merrej nga Komisioni si një deklaram që kursimet e prindërve deri në fillim të detyrës kanë qenë vetëm 180.000 lekë.

34.1.3. Komisioni ka llogaritur gabim mundësitë për kursim të prindërve për periudhën tetor 2009 - dhjetor 2012. Bazuar në vlerat e përcaktuara nga ILDKPKI-ja për vitet 2009-2011, minimumi jetik është në vlerën 136.620 lekë për person në vit, kurse për vitin 2012 është 141.024 lekë. Në bazë të llogaritjeve, si më sipër, vlera e mundësive të kursimeve për prindërit do të rritej me vlerën prej (+) 204.930 lekësh.

34.1.4. Komisioni nuk ka llogaritur mundësi kursimi të motrave të subjektit për periudhën para fillimit të detyrës. Subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* të motrave, pasi nuk ka pasur detyrim, si dhe nuk është pyetur nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni për gjendjen *cash* të tyre para fillimit të detyrës. Nga analiza financiare që ka bërë subjekti rezulton se vetëm motra A. B. për periudhën 2001-2008 ka pasur mundësi të kursejë gjendje *cash* në vlerën 1.000.000 lekë.

34.1.5. Komisioni nuk ka përfshirë si të ardhura në analizën financiare të huadhënësit/babait të subjektit, dy vlera të marra hua prej tij në janar 2013, në vlerën 1.000.000 lekë nga shtetasja M. M. dhe 800.000 lekë nga shtetasit Th. P. dhe E. P.. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka paraqitur prova të reja shkresore lidhur me huatë e dhëna nga këta shtetas, si dhe me burimin e krijimit të tyre. Pavarësisht se Komisioni e ka pranuar se subjekti e ka kundërshtuar barrën e provës, nuk ka pranuar të llogarisë në analizën financiare këto dy huadhënie. Sipas subjektit, ky qëndrim i Komisionit është në kundërshtim me ligjin pasi: (i) në bazë të ligjit nr. 84/2016 subjektet e rivlerësimit nuk kanë pasur për detyrë të deklaronin në deklaratën *vetting* huatë/dhurimet ose marrëdhëniet e tjera juridike të personave të lidhur me persona të tjerë, por vetëm kanë pasur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, sipas nenit 35/5 të ligjit nr. 84/2016; (ii) në deklaratat periodike vjetore të kryera përpara ILDKPKI-së, subjektet e rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 9049, nuk kanë pasur për detyrë të deklaronin burimet e ligjshme të dhuruesve/huadhënësve të tyre po vetëm të deklaronin me saktësi dhurimin, huanë ose çdo marrëdhënie tjetër juridike nga të cilat buronin interesa pasurore. Justifikimi i ligjshmërisë të burimit të krijimit të pasurive të dhuruesve/huadhënësve është një detyrim i cili rezulton vetëm në bazë të detyrimit kushtetues të përcaktuar nga Aneksi i Kushtetutës me titull “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

34.1.6. Marrëdhënia juridike e huasë midis shtetasit A. B. dhe personave që i kanë dhënë atij vetë hua është deklaruar rregullisht nga subjekti në respektim ligjor të pyetjeve që i janë bërë nga ana e Komisionit gjatë përgjigjeve të pyetjeve të Pyetësorit Standard, të dorëzuar nga subjekti në datën 13.03.2020, me qëllim provimin e burimeve të shumave që i janë dhënë nga ana e babait A. B.. Kjo huadhënie nuk është shtuar gjatë hetimit administrativ, pasi huadhënësi ka rezultuar në pamundësi financiare, megjithëse në atë kohë (muaji mars 2020) nuk ishte bërë asnjë lloj analize financiare nga ana e Komisionit.

34.1.7. Nga ana e Komisionit është arsyetuar se nuk është pranuar kjo marrëdhënie juridike huaje, pasi nuk është provuar [...] *me ndonjë dokumentacion të kohës (që përbën vlerë provuese)* [...]. Ky arsyetim i Komisionit është i pabazuar, pasi këto marrëdhënie juridike janë provuar me akte shkresore të thjeshta të kohës të vitit 2013 dhe me akte noteriale të cilat janë lëshuar sipas ligjit në vitin 2020. Subjekti ka paraqitur kërkesë që të thirren si dëshmitarë shtetasit M. M., Th. P. dhe E. P., por kjo kërkesë është rrëzuar nga Komisioni, me vendimin nr. {***} datë 20.01.2022.

34.1.8. Arsyetimi i Komisionit nuk është as ligjor dhe as serioz në përmbushje të detyrës së tyre, pasi nga arsyetimi i këtij vendimi duket se pranimi ose jo i marrëdhënieve juridike dhe i dokumenteve ligjore është në vlerësimin subjektiv të anëtarëve të Komisionit, të cilët mund të ndryshojnë qëndrim/mendje kur dhe si të duan, kur në fakt qëndrimi i tyre duhet të jetë ligjor dhe objektiv.

34.1.9. Nga analiza financiare për shtetasen M. M., subjekti pretendon se vetëm për periudhën janar 2009 - qershor 2012, nga të ardhurat vetëm nga paga mujore, duke ndjekur metodologjinë e Komisionit dhe duke zbritur shpenzimet jetike për këtë periudhë kohore, rezulton se kjo shtetase kishte mundësi të kursente në mënyrë kumulative gjithsej shumë prej 1.648.693 lekësh. Ndërsa shtetasit Th. P. dhe E. P., bashkëshortë me njëri-tjetrin, rezulton se vetëm për periudhën janar 2007 - dhjetor 2012, nga të ardhurat vetëm nga paga mujore, duke ndjekur metodologjinë e Komisionit dhe duke zbritur shpenzimet jetike për këtë periudhë kohore, kanë pasur mundësi të kursenin dhe të jepnin nga të ardhurat ligjore shumë prej 800.000 lekësh.

34.2. Lidhur me pagesën e këstit të dytë të apartamentit, subjekti ankimon konkluzionin e Komisionit se në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e shumës 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë në datën 6.3.2013, përdorur në datën 22.7.2015 dhe, për pasojë, nuk e konsideron këtë vlerë si burim të ligjshëm për pagesën e këstit të dytë në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, duke parashtruar se shuma 1.200.000 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit, është krijuar nga kursimet familjare të prindërve dhe motrave, me të cilët jetonte në momentin e deklarimit, dhe i është dhënë hua subjektit prej tyre. Komisioni arsyeton se kjo huamarrje nuk është deklaruar në DPV-në 2013 dhe as si burim për krijimin e depozitës referuese, si dhe as në deklaratën *vetting* dhe është shtuar më vonë si burim nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Ky arsyetim i Komisionit, sipas subjektit, nuk mbështetet në provat shkresore të administruara gjatë hetimit, ashtu dhe në atë që u vërtetua/provua gjatë seancës dëgjimore dhe që u pranua, si nga anëtarët e Komisionit në këtë seancë, ashtu edhe nga përfaqësuesi i ONM-së. Kjo shumë është deklaruar rregullisht nga subjekti: në DPV-në 2013; në deklaratimet e dhëna përpara inspektorit në ILDKPKI në vitin 2016; në deklaratën *vetting*; si dhe në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2 dhe të konfirmuar dhe në deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.11.2021, të babait A. B., ku konfirmohet marrja dhe shlyerja e kësaj shume.

35. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara më sipër, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstaton se:

35.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë: “*Apartament banimi, me sipërfaqe të përgjithshme 104,18 m² dhe me sipërfaqe të brendshme 92,42 m², të ndodhur në Tiranë, Njësia Administrative Nr. {***}, rruga “{***}”, pallati “{***}”, shkalla {***}, apartamenti {***}. Blerë me anë të kontratës së sipërmarrjes në datën 26.01.2013, në shumën gjithsej 90.000 (nëntëdhjetë mijë) euro. Paguar shuma 87.000 (tetëdhjetë e shtatë mijë) euro. Aktualisht e paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë. Pjesa takuese: 100%. Burimi: Blerë në vitin 2013 me kursimet personale përpara martesë, me kursimet familjare gjatë martesës dhe me një hua pa interes të marrë nga familjarët e Ervin Beqirit (aktualisht kjo hua është shlyer plotësisht në vitin 2016)”.*

35.2. Në deklaratën periodike vjetore 2013, subjekti ka deklaruar: “*Kontratë sipërmarrje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2013, për blerjen e një apartamenti. Paguar shuma prej 80.000 eurosh. Pjesa takuese: 100%*”. Nuk është deklaruar burimi. Në rubrikën e detyrimeve, subjekti ka deklaruar: “*Shuma prej 5.100.000 lekësh dhënë hua nga babai im shtetasi A. B. e vërtetuar nga deklaratat noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014. Detyrimi: 5.100.000 lekë*”. Në DPV-në 2013, deklarata e dytë e këtij viti, subjekti ka deklaruar: “*Kontratë sipërmarrje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2013, për blerjen e një apartamenti. Paguar shuma prej 80.000 eurosh nga kursimet familjare për vitin 2013 në shumën prej 1.263.000 lekësh nga kursimet familjare të viteve të mëparshme në shumën 4.822.000 lekësh dhe nga huaja e marrë nga shtetasi A. B. në shumën prej 5.100.000 lekësh. Vlera: 80.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi: nga kursimet familjare për vitin 2013 në shumën prej 1.263.000 lekësh nga kursimet familjare të viteve të mëparshme në shumën 4.822.000 lekësh dhe nga huaja e marrë nga shtetasit A. B. në shumën prej 5.100.000 lekësh. Po në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Shuma prej 5.100.000 dhënë hua nga babai im shtetasi A. B. e vërtetuar nga deklaratat noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014. Detyrimi: 5.100.000 lekë*”.*

35.3. Në deklaratën periodike 2014, subjekti ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2013, për blerjen e një apartamenti. Paguar gjithsej shuma prej 87.000 eurosh, ku për vitin 2014 është paguar shuma prej 7.000 eurosh. Pjesa takuese: 100%.” Nuk është deklaruar burimi. Ndërsa në rubrikën e detyrimeve nga subjekti është deklaruar: “Shuma prej 4.000.000 lekësh pa paguar, të dhënë hua pa interes e vërtetuar nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014. Paguar vlera prej 1.100.000 lekësh. Shuma prej 3.000 eurosh pa paguar shoqërisë “{***}” ShPK në bazë të kontratës së sipërmarrjes të vitit 2013”. – deklaruar si detyrim dhe në deklaratat periodike vjetore 2015 dhe 2016 dhe në deklaratën vetting. Po në këtë deklaratë, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “Mbyllur dhe tërhequr depozita në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë me afat 6-mujor nga data 10.10.2013-10.04.2014 në emër të bashkëshortes Xh. B., shuma 1.000.000 lekë. Përdorur për të paguar këstin prej 7.000 eurosh”.

35.4. Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Shuma prej 2.600.000 lekësh pa paguar, e marrë hua pa interes nga shtetasi A. B. e vërtetuar nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014. Shlyer detyrimi 1.400.000 lekë”.

35.5. Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Shlyer tërësisht detyrimi i mbetur prej 2.600.000 lekësh pa paguar nga viti i mëparshëm e marrë hua pa interes nga shtetasi A. B. e vërtetuar nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014. Shlyer detyrimi 2.600.000 lekë”.

36. Në lidhje me pagesën e këstit të parë të apartamentit, në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka përfshirë dhe llogaritur në analizën financiare mundësinë e kursimit të prindërve dhe motrave për huanë dhënë subjektit në janar 2013 prej 5.100.000 lekësh, të ardhurat nga shitja e apartamentit të ndodhur në Fier, në pronësi të prindërve, nga verifikimi i akteve, trupi gjykues konstaton se:

36.1. Me kontratën noteriale të shitblerjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2000, prindërit e subjektit, A. dhe A. B., u kanë shitur shtetasve V. dhe L. T., një apartament të ndodhur në Fier, në vlerën 1.500.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

36.2. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 03.06.2020, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, drejtuar Komisionit, rezulton se shtetasit A. B. dhe A. B. (prindërit e subjektit) kanë në pronësi pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 72,6 m², nr. pasurie {***}, {***}. {***}, {***}. {***}, që është e njëjta pasuri që ka deklaruar subjekti se është shitur dhe për të cilën në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka depozituar kontratën e shitblerjes.

36.3. Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.01.2022, të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Fier” ShA, është informuar Komisioni se [...] në sistemin Al Billing të faturimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Fier ShA nuk rezulton asnjë kontratë e lidhur me kërkuesin z. A. B. dhe znj. A. B.. Në sistemin Al Billing të faturimit të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Fier ShA rezulton një kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura në emër të abonentit znj. L. T. me nr. kontrate {***}. Kjo kontratë me nr. {***} është lidhur në fillim me abonentin z. V. T. në datën e blerjes së banesës dhe në datën 12.01.2016 është bërë ndryshimi i emrit të abonentit dhe kalimi i kontratës nga V. T. te L. T.. Pronësia e objektit të kësaj kontrate është një banesë e ndodhur në lagjen “{***}”, zona kadastrale nr. {***}, Fier. Këtë banesë z. V. T. dhe znj.

L. T. e kanë blerë nga z. A. B. e znj. A. B. me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2000.

36.4. Për të vërtetuar shitjen e apartamentit, në mungesë të regjistrimit të kësaj prone nga blerësit V. T. dhe L. T., subjekti ka kërkuar thirrjen si dëshmitarë të këtyre të fundit, kërkesë që nuk është pranuar nga Komisioni.

36.5. Në vlerësim të akteve sa më sipër, trupi gjykues vëren se, në mungesë të regjistrimit të pronës në emër të blerësve, i vetmi dokument ligjor që provon pretendimin e subjektit për shitjen e këtij apartamenti është kontrata noteriale e shitblerjes e datës 22.09.2000. Në vështrim të vendimit nr. {***}, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është konkluduar se *pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie*, trupi gjykues çmon se pavarësisht se blerësit nuk kanë kryer regjistrimin e pronës, provohet se prindërit e subjektit të rivlerësimit e kanë kryer shitjen e apartamentit, dhe janë të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e realizuara nga prindërit si rrjedhojë e shitjes së apartamentit. Por, trupi gjykues vëren se Komisioni në konkluzionin përfundimtar⁷ nuk e ka lidhur moskonsiderimin e vlerës së shitjes së apartamentit me faktin se nuk rezultoi i regjistruar në emër të prindërve, por me blerjen e një pasurie tjetër në të njëjtën kohë, në Tiranë, me deklaratimet për gjendjen *cash* në vite, si dhe me faktin se për herë të parë të ardhurat nga shitja e apartamentit deklarohen si burim për kursimet e të atit vetëm gjatë hetimit në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Subjekti nuk u është referuar të ardhurave nga shitja e apartamenti si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe në deklaratimet që ka bërë pranë ILDKPKI-së, në mars të vitit 2016, ku është pyetur dhe ka shpjeguar lidhur me burimet për dhënien e huasë prej 5.100.000 lekësh.

36.6. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk arrin të provojë dhe mospërdorimin e kësaj shume për blerjen e apartamentit nga prindërit në Tiranë, në vitin 2000. I vetmi argument që jep subjekti në këtë drejtim është se përfitimi i shumës nga shitja e apartamentit në Fier është bërë më vonë, pasi është paguar shuma për blerjen e apartamentit në Tiranë. Subjekti parashtron se në datën 18.09.2000 shitësi i apartamentit në Tiranë, A. Ç. ka deklaruar se ka marrë shumën 4.100.000 lekë nga A. B., sipas kontratës së sipërmarrjes mes palëve. Ndërkohë, nga aktet konstatohet se me kontratën e shitjes së apartamentit në Fier, palët janë shprehur se shuma e blerjes është shlyer jashtë zyrës noteriale, pa specifikuar një datë, duke rezultuar se në harkun kohor të disa ditëve nga prindërit e subjektit janë kryer transaksionet e dhënies dhe marrjes së shumave përkatëse. Për sa është konstatuar më sipër, trupi gjykues vëren se përfitimi i shumës nga shitja e apartamentit, në Fier në të njëjtën periudhë kohore me blerjen e apartamentit në Tiranë, e bën më të arsyeshëm

⁷ Komisioni në vendim shprehet se [...] trupi gjykues çmoi se pretendimi i subjektit për ta konsideruar këtë të ardhur të vitit 2000 si pjesë të gjendjes *cash* të babait të tij në fund të vitin 2012 dhe, për pasojë, edhe si burim për dhënien e huasë në vlerën 5,100,000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekë, nuk është pranuar. Së pari, prindërit e subjektit kanë krijuar menjëherë pas shitjes së pasurisë apartament në Fier një pasuri të paluajtshme tjetër, në të njëjtin vit dhe në një vlerë disa herë më shumë se vlera e pasurisë që shitën në Fier. Së dyti, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vitin 2009, në DPV-në para fillimit të detyrës, shumën 900,000 (nëntëqind mijë) lekë dhe pjesë takuese 80% [duke mbetur vlera prej 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh si gjendje *cash* e babait të tij]. Komisioni vë në dukje se subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën njësi familjare me prindërit e tij, motrat dhe mbesën në DPV-në e vitit 2009 dhe se fakti që ka deklaruar 80% të gjendjes *cash* në banesë i është referuar pjesës së tij takuese të gjendjes *cash* familjar. Së treti, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ shton si burim kursimi të babait të tij edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier në vitin 2000, burim i cili nuk gjen gjurmë as në deklaratën *vetting*, as në deklaratat periodike vjetore dhe as në procesverbalet e mbajtura nga ILDKPKI-ja më herët.

përdorimin e kësaj shume për financimin e apartamentit të Tiranës nga prindërit e subjektit. Për më tepër, subjekti nuk është bindës në pretendimet e tij se kjo shumë është mbajtur *cash* nga prindërit e tij për 13 vjet, për t'iu dhënë më pas hua atij, për blerjen e apartamentit.

36.7. Në konkluzion të sa më sipër, në kushtet kur subjekti nuk arrin të provojë përdorimin e shumës prej 1.500.000 lekësh nga të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier si burim për huanë e dhënë nga i ati, si dhe nga momenti i deklarimit të këtij burimi vetëm gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vlerëson se rezulton i bazuar qëndrimi i Komisionit që nuk e ka marrë në konsideratë këtë shumë si pjesë të gjendjes *cash* të babait, si dhe si burim për dhënien prej tij të huasë 5.100.000 lekë.

37. Lidhur me kursimet e prindërve dhe mundësinë e tyre për dhënien e huasë prej 5.100.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se nuk ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në deklaratat periodike vjetore pasuritë e prindërve ose të motrave, pavarësisht se ka bashkëjetuar me ta në të njëjtin trung familjar për një periudhë kohore. Sipas subjektit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049, detyrimin për deklarim e kanë vetëm bashkëshorti dhe fëmijët madhorë. Për këtë arsye, subjekti pretendon se nuk ka deklaruar asnjëherë sa ka qenë gjendja *cash* e kursimeve të prindërve para dhe gjatë ushtrimit të detyrës. Deklarimi prej subjektit në DPV-në 2009 i shumës *cash* prej 900.000 lekësh, ku pjesa takuese është 80% dhe sqarimi në pyetësin nr. 2 se pjesa 20% ose shuma prej 180.000 lekësh, ishte kursim i babait, nuk duhet të merrej nga Komisioni si një deklarim që kursimet e prindërve deri në fillim të detyrës kanë qenë vetëm 180.000 lekë.

37.1. Për sa parashtron subjekti më sipër, trupi gjykues vëren se është e vërtetë se sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049 subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim të deklarojë pasuritë dhe të ardhurat e prindërve dhe personave të tjerë, sipas certifikatës familjare, pasi sipas nenit 7, pika 5 të këtij ligji detyrimin për deklarim e kanë pasur vetëm bashkëshortja dhe fëmijët madhorë. Por, pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore, mungesa e detyrimit për deklarim të prindërve nuk passjell detyrimisht të provuar pretendimin se gjendja *cash* e kursyer prej tyre ka qenë më e madhe se ajo e deklaruar prej subjektit në deklaratat periodike vjetore, nëse subjekti nuk arrin të sjellë prova në mbështetje të pretendimeve të tij. Në mungesë të provave të tjera, të vetmet akte provuese për deklarimet *cash* mbeten deklarimet e subjektit në deklaratat vjetore. Në rastin e deklarimit të *cash* në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk arrin të provojë të kundërtën për sa pretendon, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se mbetet i bazuar qëndrimi i Komisionit se deklarimi i subjektit gjatë procesit të rivlerësimit mbetet deklarativ dhe i pambështetur në dokumentacion provues, në mungesë dhe të deklarimeve *vetting* nga personat e lidhur, prindërit e tij. I njëjti qëndrim mbahet nga Kolegji edhe lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se motrat kanë pasur likuiditete *cash* në vlerën prej 1.000.000 lekësh, si kursime në vitin 2009.

38. Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për mundësitë e kursimit të prindërve, subjekti pretendon se shpenzimet minimale jetike nuk duhet të ishin në vlerën prej 1.101.768 lekësh, sa ka konsideruar Komisioni, por duhet të ishin në vlerën prej 896.838 lekësh⁸. Sipas subjektit, ulja e shpenzimeve të jetesës do rriste mundësinë e kursimit të prindërve me (+) 204.930 lekë.

⁸ Si total i shpenzimeve të jetesës për prindërit: për periudhën tetor-dhjetor 2009, prej 68.310 lekësh; për vitet 2010-2011, prej 273.240 lekësh për secilin vit; si dhe prej 282.048 lekësh për vitin 2012 (duke u mbështetur në të dhënat që Komisioni i ka dërguar subjektit dhe që u janë referuar shpenzimeve të ILDKPKI-së me burim INSTAT).

38.1. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton, nga verifikimi i akteve në fashikuj, se dhe pse në narrativë në vendim, Komisioni është shprehur për periudhën nga fillimi i detyrës (tetor 2009), analiza financiare e prindërve të subjektit është kryer e plotë, duke përfshirë gjithë vitin 2009, deri në vitin 2012. Gjithashtu, konstatohet se Komisioni ka përllogaritur elementet e tjerë në analizë, duke i konsideruar për gjithë vitin 2009, si dhe në total për gjithë periudhën deri në fund të vitit 2012 (përveç investimeve në depozitë që do të shpjegohen më poshtë). Pra, pretendimi i subjektit për të llogaritur shpenzimet e jetesës për vitin 2009, vetëm për periudhën tetor-dhjetor 2009 dhe jo për gjithë vitin 2009, nuk qëndron, pasi Komisioni, ashtu si dhe subjekti në analizën e tij, ka konsideruar të ardhurat për total vitin 2009, ashtu dhe për vitet e tjera deri në fund të vitit 2012.

39. Referuar kontrollit të analizës së mundësisë së prindërve për kursime deri në fund të vitit 2012, në Kolegj konstatohet se në analizën e Komisionit në vendim, elementi *“Investime në depozitë me afat 2009 - 2012”* konsideruar shtesë në vlerën prej 413.158 lekësh, duhet të ishte pakësim në vlerën prej (-) 46.082 lekësh. Konstatohet se sipas akteve në fashikuj, Komisioni ka llogaritur diferencën e likuiditeteve bankare që prindërit kishin më 31.12.2012 me likuiditetet në fund të vitit 2009, pra, në vlerën shtesë prej 413.158 lekësh⁹. Por referuar të ardhurave dhe shpenzimeve që ka konsideruar në analizë për gjithë vitin 2009 e deri në fund të vitit 2012, Komisioni duhet të kishte konsideruar diferencën e likuiditeteve bankare që prindërit kishin më 31.12.2012, me likuiditetet në fund të vitit 2008 (apo në fillim vitit 2009), pra, me pakësim prej (-) 46.082 lekësh¹⁰. Korrigjimi në analizën e kryer nga Komisioni për mundësinë e kursimit të prindërve e elementit në analizë *“Investime në depozitë me afat 2009 -2012”*, në vlerën pakësim prej (-) 46.082 lekësh (nga shtesë prej 413.158 lekë konsideruar nga Komisioni) do të rezultonte se mundësia e kursimit të prindërve në fund të vitit 2012 do të ishte 2.066.172 lekë¹¹ (nga 1.606.932 lekë, sipas analizës së Komisionit).
40. Në vijim të sa arsyetuar më sipër, ashtu si dhe Komisioni, duke konsideruar kursimet para vitit 2009 për gjithë familjen, vlerën e likuiditetit *cash* deklaruar nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës prej 180.000 lekësh (si pjesa takuese e mbetur prej 20% e vlerës deklaruar 900.000 lekë e pjesa e subjektit e deklaruar prej 80%), duke mos marrë në konsideratë pretendimet për *“kursime para vitit 2009”*, për prindërit dhe motrat, si dhe duke korrigjuar vetëm elementin *“Investime depozite me afat”* të analizës së prindërve në pakësim prej (-) 46.082 lekësh (nga vlera 413.158 lekë konsideruar nga Komisioni), atëherë rezulton se kursimet e mundshme për familjen (prindërit

⁹ Si diferencë e vlerës 1.137.297 lekë [gjendja e llogarisë me nr. {***} në ProCredit Bank e A. B. referuar nxjerrjes së llogarive bashkëlidhur shkresës që banka i ka dërguar Komisionit me nr. {***} prot., datë 13.05.2020], me likuiditetet në fund të vitit 2009, në vlerën 724.137 lekë [gjendja e llogarisë me nr. {***} në ProCredit Bank e A. B. referuar nxjerrjes së llogarive bashkëlidhur shkresës që banka i ka dërguar Komisionit me nr. {***} prot., datë 13.05.2020], pra, e barabartë me 413.158 lekë.

¹⁰ Si diferencë e vlerës 1.137.297 lekë, gjendje më 31.12.2012, me likuiditetet në fund të vitit 2008 (apo në fillim vitit 2009), të cilat sipas akteve në fashikuj ka qenë në vlerën 1.183.379 lekë [si total i likuiditeteve në ProCredit Bank në llogaritë me nr. {***} me vlerë 1.183.000 lekë dhe balanca në llogarinë me nr. {***} në emër të A. B. referuar nxjerrjes së llogarive bashkëlidhur shkresës që banka i ka dërguar Komisionit me nr. {***} prot., datë 13.5.2020.], pra, e barabartë me pakësim prej (-) 46.082 lekësh.

¹¹ Referuar analizës së Komisionit, sipas tabelës në vendim, në faqen 20, duke korrigjuar vetëm *“Investimet në depozitë”* [në pakësim prej (-) 46.082 lekësh nga shtesë prej (+) 413.158 lekësh], *“(1) Mundësi për kursim prindërit”* do të ndryshonte nga vlera prej 1.606.932 lekësh duke u rritur në vlerën prej 2.066.172 lekësh.

dhe motrat) në fund të vitit 2012, do të ishin në vlerën prej 4.871.249 lekësh¹² (pra, 459.240 lekë më shumë se vlera prej 4.412.009 lekësh në analizën e Komisionit).

41. Subjekti i rivlerësimit pretendon që në analizën e vitit 2010 likuiditetet në *cash* të konsiderohen në vlerën 1.300.000 lekë, pasi deklarimi në vitin 2010 është një gabim material/ pasaktësi në deklarim për gjendjen *cash*. Sipas subjektit, Komisioni ka gabuar kur e ka konsideruar gjendjen *cash* 1.000.000 lekë, në kundërshtim të akteve të administruara gjatë procesit hetimor, të cilat përbëjnë provë shkresore dhe nuk janë pasqyruar në vendim.

41.1. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim është shprehur dhe ka mbajtur qëndrimin se: *“Trupi gjykues nuk ka pranuar kërkesën e subjektit për përfshirjen e shumës që rezulton si balancë pozitive e këtij viti, si gjendje cash në fund të vitit dhe e transferuar në vitin pasardhës, duke reflektuar në analizë financiare gjendjen cash në vitin 2010, sipas DPV-së të bërë më herët nga subjekti rivlerësimit në DPV-në përkatëse, në shumën 1.000.000 (një milion) lekë”*¹³. Komisioni ka pranuar arsyetimin e subjektit për të llogaritur në analizën financiare të vitit 2010 të ardhurat e krijuara nga bashkëshortja para martese në vitet 2008 – 2009, në shumën totale prej 530.322 lekësh, shërbyer si burim për krijimin e likuiditeteve në “Alpha Bank, duke marrë në konsideratë të ardhurat për krijimin e depozitës në datën 21.4.2010, në shumën 400.000 lekë, si të ardhura të ligjshme të bashkëshortes të krijuara nga puna e saj dhe duke i përfshirë në analizë financiare për çeljen e depozitës në “Alpha Bank” në emrin e saj. Në vijim të kësaj logjike, situata negative financiare e vitit 2010 ka ndryshuar duke rezultuar ky vit me balancë pozitive prej (+) 322.000 lekësh.

41.2. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, nga aktet rezulton se në DPV-në 2010 subjekti ka deklaruar: *“Para cash në shtëpi, shtuar me 600.000 lekë nga kursimet vjetore të miat dhe të bashkëshortes sime. Vlera: 1.000.000 lekë”*. Në deklarimet pranë ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të datës 17.02.2012¹⁴, subjekti ka shpjeguar se në DPV-në 2010 për depozitën në “Alpha Bank” ka deklaruar jo saktë vlerën e saj prej 1.017.882 lekësh, pasi në momentin e deklarimit i është referuar gjendjes së aseteve deri në momentin e deklarimit dhe jo datës 31.12.2010. Konstatohet se në këtë procesverbal në përgjigjet e pyetjes nr. 2, lidhur me deklarimet e likuiditeteve *cash* nga 2009 - 2013, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar [...] *në vitin 2010 gjendja ka qenë afërsisht 1.200.000 lekë, sepse shtesa në cash pavarësisht se është deklaruar 600.000 nuk ka qenë ekzaktësisht, por ka qenë afërsisht rreth 800.000 lekë. Kjo shumë nuk është deklaruar, pasi një shumë prej afro 200.000 lekësh nga gjendja cash është pakësuar në fillim të vitit 2011 përpara se të bëhej deklarimi për vitin 2010 [...]”*. Nga verifikimi i kryer në Kolegj, nga lëvizjet bankare konstatohet se depozita në datën 31.12.2010 ka qenë në vlerën 710.469 lekë dhe në datën 14.01.2011 është shtuar me 300.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit në ankim referon dhe përgjigjet e dhëna në procesverbalin e datës 04.03.2016, në ILDKPKI për kontrollin e deklaratave 2009-2014, konkretisht në pyetjet 4 dhe 5, të cilat lidhen me depozitën në “Alpha Bank” të deklaruar në DPV-në 2010, jo me balancën në datën 31.12.2010, por me atë që ka pasur në momentin e deklarimit, 300.000 lekë më shumë.

¹² Si rezultat i: a) analizës së mundësisë së kursimit të prindërve, sipas Komisionit, por korrigjuar vetëm “Investimet në depozitë” [në (-) 46.082 lekë nga (+) 413.158 lekë], e cila rezulton në vlerën prej 2.066.172 lekësh; dhe b) analizës së mundësisë së kursimit të motrave, sipas analizës së Komisionit në vlerën prej 2.805.077 lekësh.

¹³ Paragrafi i fundit i shkronjës “ç”, të pikës 50 të vendimit të Komisionit.

¹⁴ Bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 21.10.2021, që ILDKPKI-ja i ka dërguar Komisionit.

41.3. Nga leximi dhe analiza e deklaramëve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit për gjendjen *cash*, në kushtet kur konstatohet se shpjegimet e subjektit mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar janë kontradiktore dhe bien ndesh me deklaramet e tij në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2010, e cila konsiderohet provë në procesin e rivlerësimit në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se pretendimi i subjektit se gjendja *cash* në vitin 2010 ka qenë në vlerën 1.300.000 lekë mbetet në nivel deklarativ.

42. Lidhur me pretendimet e subjektit për mundësinë e tij dhe të bashkëshortes për kursime deri në fund të vitit 2012 për pagesën e këstit të parë të apartamentit, konstatohet se Komisioni ka konsideruar se në datën 31.12.2012, vlera e likuiditeteve *cash* që mund të kursente subjekti me burime të ligjshme ka qenë në vlerën prej 1.652.577 lekësh¹⁵.
43. Referuar kontrollit të analizës së vitit 2011, në Kolegj ka rezultuar se diferenca negative është (-) 173.036 lekë [39.912 lekë më pak se rezultati i Komisionit prej (-) 212.948 lekësh], kjo duke konsideruar se likuiditetet *cash*, ashtu si dhe Komisioni ka konsideruar më 31.12.2010 (fillim i vitit 2011 në analizë) kanë qenë 1.000.000 lekë, pavarësisht pretendimit të subjektit (trajtuar më sipër), por duke reflektuar ndryshime në elementet në analizë ku kanë rezultuar të ardhura më të larta prej 41.258 lekësh¹⁶ dhe ndryshim i gjendjes së likuiditeteve¹⁷.
44. Në përfundim, për sa i përket mundësisë së kursimeve të subjektit deri në fund të vitit 2012, nga kontrolli i kryer në Kolegj, konstatohet se mundësia e kursimeve të subjektit dhe bashkëshortes, përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit, është në vlerën prej 1.756.964 lekësh¹⁸, pas korrigjimit të analizës së vitit 2011 trajtuar më sipër.
45. Subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e Komisionit, i cili nuk ka përfshirë si të ardhura në analizën financiare të huadhënësit/babait të tij, dy hua të marra prej tij në janar 2013, në vlerën 1.000.000 lekë nga shtetasja M. M. dhe në vlerën 800.000 lekë nga shtetasit Th. P. dhe E. P.. Subjekti pretendon se pas kalimit të barrës së provës ka paraqitur prova të reja shkresore lidhur me huatë e dhëna nga këta shtetas, si dhe me burimin e krijimit të tyre, por Komisioni nuk ka pranuar të llogarisë në analizën financiare këto dy huadhënie. Sipas subjektit, ky qëndrim i Komisionit është në kundërshtim me ligjin, pasi në bazë të ligjit nr. 84/2016 subjektet e rivlerësimit nuk kanë pasur për detyrë të deklaronin në deklaratën *vetting* huatë/dhurimet ose marrëdhëniet e tjera

¹⁵ Duke i zbritur vlerës së deklaruar prej 1.930.000 lekësh, diferencat negative për periudhën nga 13.10.2009-31.12.2009 prej 64.475 lekësh dhe të vitit 2011 prej 212.948 lekë dhe ka rezultuar se mund të kursente deri në vlerën 1.652.577 lekë me burime të ligjshme.

¹⁶ Si total i a) "Të ardhura nga paga SR", ndryshon me Komisionin nga 945.303 lekë në 956.562 lekë (+ 11.259 lekë), pasi në llogarinë e pagës në "Raiffeisen Bank" kanë kaluar dhe honorare më 20.06.2011, me përshkrim "honorare Ervin Beqiri" shuma 5.859 lekë dhe më 14.07.2011 ka kaluar kreditim me përshkrim "Ervin Beqiri" me vlerë 5.400 lekë, e cila përkon me informacionin nga vërtetimi nga Shkolla Magjistraturës nr. {***} prot., datë 20.10.2016 (ILDKPKI aneksi 4/4) se në 2011 ka marrë pagesë neto 5.400 lekë si "lehtësues PTV" (PTV Program Trajnimit Vazhdues); b) "Të ardhura nga paga bashkëshortja", ndryshon me Komisionin nga 804.046 lekë në 834.046 lekë (+ 30.000 lekë) referuar kalimeve nga UK Librazhd në "Raiffeisen Bank", ka diferencë se Komisioni duket se e ka futur pagesën prej 30.000 lekësh në 2010, referuar vërtetimit nga UK Librazhd (viti 2010 prej 120.000 lekë dhe viti 2011 prej 60.000 lekë), por në bankë 30.000 lekë të vitit 2010 kanë kaluar në datën 27.01.2011.

¹⁷ Ka diferencë me Komisionin prej 1.346 lekësh, kjo lidhur me balancat e llogarive që Komisioni nuk i kishte konsideruar në "Raiffeisen Bank" e bashkëshortes me nr. {***}, e balancë fillim periudhe prej 77 lekësh e fund periudhe prej 433 lekësh, në BKT në llogarinë me nr. {***}, në fund periudhe me balancë prej 986 lekësh.

¹⁸ Duke i zbritur kursimeve të deklaruar prej 1.930.000 lekësh diferencën negative të vitit 2011 prej 173.036 lekësh. Diferenca negative e periudhës nga 13.10.2009-31.12.2009, prej (-) 64.475 lekësh është konsideruar në totalin e viteve të tjera në analizë.

juridike të personave të lidhur me persona të tjerë, por vetëm kanë pasur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre.

45.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka pasur për detyrë të deklaronte në deklaratën *vetting* huatë/dhurimet ose marrëdhëniet e tjera juridike të personave të lidhur me persona të tjerë, së pari sillet në vëmendje se babai i subjektit të rivlerësimit, si person i lidhur, në të njëjtën certifikatë familjare, ka pasur detyrimin për deklarim në deklaratën *vetting*, detyrim i cili rezultoi se nuk është plotësuar në momentin e dorëzimit të kësaj deklaratë, pavarësisht se subjekti më vonë me rezultatet e hetimit ka paraqitur të plotësuara edhe deklaratat *vetting* të familjarëve të tij.

45.2. Trupi gjykues vëren se pavarësisht se huatë nuk janë marrë direkt nga subjekti i rivlerësimit, por nga babai i tij, i cili vetë ka qenë në pozitë të huadhënësit, këto hua kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, babai është person i lidhur, shuma e marrë hua nga babai ka shërbyer për krijimin e pasurisë apartament dhe subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte dhe të provonte me dokumentacion justifikues ligjor burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për likuidimin e kësteve për shlyerjen e çmimit të blerjes së këtij apartamenti me qëllim për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurisë, në momentin e krijimit të saj.

45.3. Subjekti parashtron në ankim se në kundërshtim nga sa ka konkluduar Komisioni, këto huadhënie nuk janë shtuar gjatë hetimit administrativ, për shkak se huadhënësi/babai ka rezultuar në pamundësi financiare, pasi në atë kohë, muaji mars 2020, nuk ishte bërë asnjë lloj analize financiare nga ana e Komisionit. Marrëdhënia juridike e huasë, midis babait të subjektit të rivlerësimit dhe personave që i kanë dhënë atij vetë hua, është deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetjeve që i janë bërë nga ana e Komisionit gjatë përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit standard, pika 19, të dorëzuar nga subjekti në datën 13.03.2020, me qëllim për të provuar burimet e shumave që i janë dhënë nga ana e babait A. B..

45.4. Lidhur me sa parashtron subjekti i rivlerësimit, Kolegji konstaton se qëndron pretendimi i subjektit se këto huadhënie nuk janë deklaruar për efekt të analizës financiare të kryer nga Komisioni, pasi deklarimi i këtyre huave, si burim për krijimin e huasë që babai i subjektit i ka dhënë subjektit është deklaruar në përgjigjen e pyetësorit standard, pyetja 19/b, dërguar Komisionit me e-mail në datën 13.03.2020, moment kur subjekti nuk ka pasur dijeni për analizën financiare të kryer në Komision, e cila i ka kaluar subjektit bashkë me raportin e rezultateve hetimore, në datën 31.01.2022.

45.5. Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit që ka arsyetuar se nuk është pranuar kjo marrëdhënie juridike huaje, pasi nuk është provuar [...] me ndonjë dokumentacion të kohës (që përbën vlerë provuese) [...]. Ky arsyetim i Komisionit, sipas subjektit, është i pabazuar, pasi këto marrëdhënie juridike janë provuar me akte shkresore të thjeshta të kohës të vitit 2013 dhe me akte noteriale të cilat janë lëshuar sipas ligjit në vitin 2020. Subjekti ka paraqitur kërkesë që të thirren si dëshmitarë shtetasit M. M., Th. P. dhe E. P., por kjo kërkesë është rrëzuar nga Komisioni, me vendimin nr. {***}, datë 20.01.2022.

45.6. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji vëren se Komisioni në vendim është shprehur se konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar mbi burimin e të ardhurave të familjes {***} dhe/apo hallës së tij, znj. M. M., si dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor në

mbështetje të deklarimeve të tij - për të provuar ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave të këtyre shtetaseve që mund të kenë shërbyer për dhënien e huave babait të tij mbështetur në detyrimin, sipas pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

45.7. Nga aktet rezulton se subjekti ka paraqitur në Komision për huanë e dhënë babait nga motra M. M.: i) *deklaratë të thjeshtë me shkrim, të datës 22.01.2013, me të cilën dy palët deklarojnë marrjen/dhënien e huasë në vlerën 1.000.000 lekë; ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.03.2020, në të cilën shtetasja M. M. deklaron dhënien e shumës një milion lekë vëllait të saj A. B.; iii) dokumentacion nga ISSH-ja për të ardhurat dhe kontributet nga punësimi dhe pensionet.*

45.8. Kolegji konstaton se Komisioni nuk u ka dhënë vlerë provuese këtyre akteve dhe ka çmuar se kjo hua mbetet në nivel deklarativ dhe nuk e ka pranuar si burim për krijimin e huasë të dhënë nga babai, pasi: *ky burim nuk është deklaruar në deklaratën noteriale të babait të subjektit, të datës 18.03.2014 dhe në pyetësorët e ILDKPKI-së në vitin 2016; babai i subjektit ka pasur gjendje likuiditetesh në bankë në periudhën kur deklarohet se është dhënë huaja dhe marrja e një shume hua një të treti nuk duket logjike dhe bindëse për trupin gjykues.*

45.9. Në vlerësim të pretendimit të subjektit se ka provuar me akte shkresore të thjeshta dhe me akte noteriale dhënien e huasë, trupi gjykues sjell në vëmendje se lidhur me vlerën provuese të shkresave private, konkretisht të deklaratës së thjeshtë me shkrim të vitit 2013, neni 261 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se shkresa private merr datë të saktë kundrejt personave të tretë vetëm nga dita që është vërtetuar nga noteri ose nëpunësi publik kompetent sipas ligjit. Ndërsa për sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.03.2020, Kolegji ka tashmë një qëndrim të konsoliduar¹⁹, sipas së cilit deklaratat e paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit nuk kanë efekt provues në këtë proces, nëse nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

45.10. Për sa më sipër, për faktin se kjo hua nuk është e dokumentuar me akte provuese për kohën kur deklarohet se është dhënë, nuk është deklaruar në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën *vetting* (si burim i huasë për blerjen e apartamentit), si dhe duke qenë se është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar konkluzioni i Komisionit se ekzistenca e kësaj huaje mbetet në nivel deklarativ.

45.11. Lidhur me huanë e dhënë nga shtetasit Th. P. dhe E. P., subjekti ka paraqitur dokumentet: i. *deklaratë e thjeshtë me shkrim të datës 25.01.2013, në të cilën Th. P. dhe E. P. deklarojnë se i kanë dhënë hua shtetasit A. B. një shumë prej 800.000 (tetëqind mijë) lekësh të reja për të ndihmuar djalin e tij Ervin Beqiri për të blerë një apartament në qytetin e Tiranës; ii. deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.03.2020, ku këta shtetas kanë deklaruar se i kanë dhënë në datën 25.01.2013 shtetasit A. B. një shumë hua prej 800.000 lekësh; iii. kontrata sipërmarrjeje të shoqërisë “{***}” ShPK, lëvizjet bankare të Th. P. dhe E. P., si dhe vërtetime nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSH) për pagesat e sigurimeve shoqërore.*

45.12. Trupi gjykues vlerëson se edhe në këtë rast, ashtu si dhe në rastin e huasë së dhënë nga shtetasja M. M., vlen i njëjti qëndrim lidhur me vlerën provuese të akteve të paraqitura nga subjekti.

¹⁹ *Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR); nr. 11/2019 (JR); nr. 34/2019 (JR).*

45.13. Në konkluzion, lidhur me dy huatë e marra nga babai i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar qëndrimi i Komisionit se këto dy hua mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion të kohës.

46. Në përfundim, lidhur me pagesën e kështit të parë të apartamentit me sipërfaqe 104,18 m², të ndodhur në Tiranë, trupi gjykues vlerëson si të bazuar konkluzionin e Komisionit se babai i subjektit të rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për dhënien e huasë në vlerën (-) 228.751 lekë²⁰ dhe se subjekti rezulton në pamundësi financiare në shumën (-) 382.287 lekë²¹ për pagesën e këtij kështi.

47. Lidhur me pagesën e kështit të dytë të apartamentit, subjekti ankimon konkluzionin e Komisionit se në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e shumës 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë në datën 6.3.2013, përdorur në datën 22.7.2015 dhe, për pasojë, nuk e konsideron këtë vlerë si burim të ligjshëm për pagesën e kështit të dytë në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, duke parashtruar se shuma 1.200.000 lekë, sipas subjektit të rivlerësimit, është krijuar nga kursimet familjare të prindërve dhe motrave, me të cilët jetonte në momentin e deklarimit dhe i është dhënë hua subjektit prej tyre. Komisioni arsyeton se kjo huamarrje nuk është deklaruar në DPV-në 2013 dhe as si burim për krijimin e depozitës referuese, si dhe as në deklaratën *vetting* dhe është shtuar më vonë si burim nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Ky arsyetim i Komisionit, sipas subjektit, nuk mbështetet në provat shkresore të administruara gjatë hetimit, ashtu dhe në atë që u vërtetua/provua gjatë seancës dëgjimore. Kjo shumë është deklaruar rregullisht nga subjekti: në DPV-në e vitit 2013; në deklaratimet e dhëna përpara inspektorit në ILDKPKI në vitin 2016; në deklaratën *vetting*; si dhe në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2 dhe të konfirmuar dhe në deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.11.2021, të babait A. B., ku konfirmohet marrja dhe shlyerja e kësaj shume.

47.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vëren se ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nga aktet në fashikuj rezulton se në DPV-në 2013²² ai ka deklaruar vetëm lidhur me huanë 5.100.000 lekë të marrë nga babai për pagesën e kështit prej 80.000 eurosh, vërtetuar nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014, por nuk referon për marrjen e huasë tjetër prej 1.200.000 lekësh nga prindërit dhe motrat. Subjekti pretendon se e ka bërë deklarin në vitin 2013, duke e lidhur me deklaratën e plotësuar nga bashkëshortja për këtë vit, e cila në DPV-në e vitit 2013 (deklarata e re e plotësuar) ka deklaruar [...] shtuar në llogari bankare në datën 06.03.2013, shuma prej 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekësh, nga kursimet familjare [...].

²⁰ Referuar huasë së deklaruar prej 5.100.000 lekësh në janar 2013, sipas analizës së mundësisë për kursimeve të prindërve dhe motrave (trajtuar më sipër) ka rezultuar se mund të kursenin vlerën prej 4.871.249 lekësh.

²¹ Referuar analizës së Komisionit në paragrafin 84 në vendim, pagesa e kështit të parë prej 7.010.500 lekësh (ekuivalenti i 50.000 euro), sipas korrigjimit në Kolegj, ka rezultuar i pambulluar me burime të ligjshme në vlerën prej 382.287 lekësh, nga totali i mundësive të kursimit të prindërve e motrave për të dhënë huanë në vlerën prej 4.871.249 lekësh dhe mundësisë së kursimeve të subjektit dhe bashkëshortes, në vlerën prej 1.756.964 lekësh.

²² Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, subjekti ka deklaruar të detyrimet: "Shuma prej 5.100.000 dhënë hua nga babai im shtetasi A. B. e vërtetuar nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014. Detyrimi: 5.100.000 lekë". Në deklaratën e dytë e këtij viti, deklarohet: "Shuma prej 5.100.000 dhëne hua nga babai im shtetasi A. B. e vërtetuar nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.03.2014. Detyrimi: 5.100.000 lekë". "Shuma prej 10.000 eurosh pa paguar shoqërisë "{***}" ShPK në bazë të kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2013".

47.2. Trupi gjykues vëren se pavarësisht sa pretendon subjekti, si në deklaratimet e tij, ashtu dhe në ato të personit të lidhur, bashkëshortes, nuk rezultojnë të jetë përmendur një hua tjetër e dhënë nga babai, nga kursimet familjare të prindërve dhe motrave. Duke qenë se kjo hua ka shërbyer për blerjen e apartamentit, subjekti ka pasur detyrimin ligjor që ta deklaronte atë në deklaratën periodike vjetore, pavarësisht faktit se pretendon se kjo hua është shlyer brenda vitit. Rezultojnë se dhe në deklaratën *vetting* subjekti nuk ka bërë deklaratë të kësaj huaje, që ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të dytë të apartamentit. Në këtë deklaratë ai është shprehur se vetëm një pjesë e këtij apartamenti është blerë me një hua, pa interes, të marrë nga familjarët (*aktualisht hua e shlyer plotësisht në vitin 2016*), pra, jo për dy hua siç pretendon subjekti në ankim, pa e specifikuar vlerën e kësaj huaje dhe për cilat pagesa ka shërbyer. Dhënia e huasë prej 1.200.000 lekësh në datën 06.03.2013, nuk përmendet as në deklaratën noteriale të vitit 2014 të babait, në të cilën ai deklaroi vetëm për dhënien e huasë në janar 2013, në shumën 5.100.000 lekë. Për herë të parë deklarimi i kësaj huaje nga subjekti bëhet në vitin 2016, gjatë kontrollit në ILDKPKI dhe, më pas, gjatë hetimit administrativ në Komision.

48. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ai ka dorëzuar në Komision dhe një deklaratë tjetër noteriale nga babai, të datës 11.11.2021, për të cilën pretendon se e ka sjellë si përgjigje ndaj kërkesës së Komisionit, Kolegji përsërit qëndrimin e tij se për sa kohë nuk është e shoqëruar me dokumente të tjera, fuqia provuese e deklaratës noteriale nuk është bindëse për faktin se është dhënë vetëm në kuadër të procesit të rivlerësimit²³.
49. Trupi gjykues vlerëson si të pabazuara kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit ndaj konstatimit të Komisionit se babai i tij rezultoi në pamundësi financiare, për krijimin e shumës 1.200.000 lekësh, dhënë hua subjektit në mars të vitit 2013. Nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare të kryer në Komision, deri në vitin 2012, rezultoi se babai i subjektit do të ishte në pamundësi financiare për mbulimin e huasë prej 1.200.000 lekësh, pretenduar e dhënë në muajin mars 2013, pasi kursimi i mundshëm në fund të vitit 2012 është 4.871.249 lekë, shumë kjo që nuk mbulon as dhënien e huasë në janar 2013, në vlerën prej 5.100.000 lekësh.
50. Në përfundim sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk arrin të provojë me akte marrjen e huasë për pagesën e këstit të dytë të apartamentit, nuk e ka deklaruar këtë hua në deklaratat periodike vjetore, si dhe nuk e ka specifikuar marrjen e saj në deklaratën *vetting*. Për pagesën e këstit të dytë në shumën 30.000 euro, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e shumës 1.200.000 lekë që ka shërbyer për pagesën e këtij kësti.
51. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për gabime materiale në analizën financiare të kryer në Komision, trupi gjykues, pasi sjell në vëmendje se një pjesë e tyre janë trajtuar më sipër në këtë vendim²⁴, analizon si vijon.

51.1. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se paga e tij për periudhën 13.10.2009-31.12.2009, në analizën e Komisionit për vitin 2009, nuk duhet të jetë në vlerën 147.759 lekë, por në vlerën 232.766 lekë, pasi duhet shtuar edhe vlera 85.006,97 lekë që është paga e muajit dhjetor. Lidhur me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton nga aktet se sipas vërtetimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të datës 18.10.2016, të ardhurat *neto* për

²³ *Shih Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1 dhe nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.*

²⁴ *Lidhur me mundësinë e kursimeve të prindërve, motrave dhe subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2012.*

periudhën tetor-dhjetor 2009 janë në vlerën 211.946 lekë. Nga lëvizjet e llogarisë bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank”, sjellë bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 11.05.2020, që kjo bankë i ka dërguar Komisionit, gjatë periudhës në analizë, 13.10.2009-31.12.2009, janë kredituar në llogarinë e subjektit të ardhura në vlerën prej 147.759 lekësh – vlerë të cilën e ka konfirmuar dhe Komisioni duke e përfshirë në analizën e periudhës. Referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vlerës konsideruar nga Komisioni në analizë (prej 147.759 lekësh) duhet t’i shtohet dhe vlera prej 85.006,97 lekësh, e cila është paga e muajit dhjetor 2009, pra, të konsiderohet vlera totale prej 232.766 lekësh në analizë, vërehet se sipas vërtetimit të pagës, cituar më sipër, paga për periudhën ka qenë 211.946 lekësh dhe duke zbritur vlerat e kaluara pranë “Raiffeisen Bank”, deri në datën 31.12.2009, prej 147.759 lekësh, rezulton vlera prej 64.187 lekësh. Paga të cilës subjekti i referohet si paga e muajit dhjetor 2009 prej 85.006,97 lekësh, e pretenduar të konsiderohet në llogaritje, nuk përkon sipas vërtetimit të institucionit me pagën e muajit dhjetor 2009 edhe referuar akteve në fashikuj, sipas lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit në “Credins Bank”, sjellë bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 19.08.2020, që banka i ka dërguar Komisionit, sipas së cilës paga e muajit dhjetor 2009 ka kaluar në datën 05.01.2010, në vlerën 64.187 lekë, me përshkrimin “*Prokuroria Tiranë dhjetor 2009*”.

51.2. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues, duke çmuar se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për konsiderimin e shumës prej 232.766 lekësh, si të ardhura nga paga për vitin 2009, konfirmon minimalisht balancën negative prej (-) 64.475 lekësh të analizës së Komisionit, për periudhën 13.10.2009-31.12.2009.

51.3. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizën e vitit 2014 të të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortes në vlerën prej 154.108 lekësh, konstatohet se Komisioni në vendim ka konkluduar: *179. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja si person tregtar fizik, subjekti i rivlerësimit kërkon që në analizë financiare të vitit 2014 të përfshihen edhe pagat që ka përfituruar si e vetëpunësuar, konkretisht, duhet të llogaritet dhe një vlerë shtesë prej 154.000 (njëqind e pesëdhjetë e katërmijë) lekësh. Kjo shumë është njohur si një shpenzim që nuk është kryer në fakt, i cili duhet të zerohet/hiqet duke shtuar kështu fitimin për shtetasen Xh. B..* Në analizën e vitit 2014, Komisioni ka përfshirë jo vlerën prej 154.108 lekësh, të pretenduar nga subjekti, por vlerën prej 115.296 lekësh, duke mos shpjeguar se ku është mbështetur në konsiderimin e kësaj vlere. Nga verifikimi i akteve në fashikuj konstatohet se Komisioni i është referuar shkresës nr. {***} prot., datë 08.05.2020, të ISSH-së, sipas së cilës personi fizik “Xh. B.”, me NIPT{***}, për periudhën maj- shtator 2014, ka pasur pagesa prej 95.890 lekësh dhe për periudhën dhjetor 2014, prej 19.406 lekë, në total prej 115.296 lekësh. Referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit se *pavarësisht se Komisioni në paragrafin 179 dhe 181 të vendimit ka pranuar të përfshijë në analizën e viteve 2014-2015 të ardhurat nga paga të bashkëshortes si e vetëpunësuar në vlerën 154.000 lekë, në fakt në analizën financiare në vendim ka bërë një gabim material dhe e ka reflektuar në vlerën 115.296 lekë,* konstatohet se Komisioni nuk ka gabim material, por i ka konsideruar të ardhurat jo në vlerën e pretenduar nga subjekti, por referuar vërtetimit të lëshuar nga ISSh-ja, dërguar Komisionit. Referuar analizës së vitit 2014 në Komision, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me balancë negative prej (-) 11.936 lekësh, balancë e cila konfirmohet minimalisht dhe nga Kolegji.

51.4. Subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me analizën e vitit 2015, ka pretenduar se në të ardhurat/fitimet nga Personi Fizik Xh. B. duhet të shtohet dhe vlera e TVSh-së prej 100.000 lekësh. Për sa përket të ardhurave të realizuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, konstatohet

se Komisioni në analizën e rezultateve hetimore për vitin 2015, referuar të ardhurave nga fitimi i aktivitetit si person fizik i bashkëshortes ka konsideruar fitimin, sipas Formularit të Deklarimit të Tatimit të Thjeshtuar mbi fitimin bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 08.11.2021, që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i ka dërguar Komisionit, sipas së cilës fitimi mbas tatimit ka rezultuar në vlerën prej 1.336.329 lekësh. Referuar lëvizjeve të llogarisë në BKT me nr. {***}, në emër të Xh. B., Komisioni ka konstatuar se faturat tatimore të datës 30.12.2015 janë likuiduar në vitin 2016, pra, kanë kaluar në llogari në datën 05.01.2016 e, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përllogaritur si të përfituara në vitin 2015, siç është shpjeguar në shpjegimet bashkëlidhur rezultateve hetimore e janë konsideruar në vitin 2016²⁵. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në zbatim të legjislacionit tatimor, sipas së cilit *pagesat e detyrimeve për TVSH-në të subjekteve tregtare fizikë/juridikë mund të paguhet deri në muajin pasardhës për detyrime që kanë lindur gjatë muajit të mëparshëm*, TVSH-ja për muajin dhjetor 2015 është paguar në datën 20.01.2016, pranë “Raiffeisen Bank” dhe e ardhura/fitimi nga aktiviteti si person fizik i bashkëshortes së subjektit për vitin 2015 duhet të përfshijë dhe pjesën e vlerës së TVSH-së prej 100.000 lekësh nga vlera e faturës prej 600.000 lekësh. Në përfundim trupi gjykues, referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit, duke konsideruar rishikimin dhe korrigjimin e “të ardhura/fitime nga aktiviteti i Personit Fizik “Xh. B.”, vetëm për vlerën e pretenduar në ankim nga subjekti të TVSH-së paguar në janar 2016 prej 100.000 lekësh, konkludon se diferenca negative për vitin 2015 do të ulej në (-) 434.431 lekë, nga (-) 534.431 lekë, që ka konkluduar Komisioni në vendim.

52. Në konkluzion, për krijimin e pasurisë apartament banimi me sip. 104,18 m², në Tiranë, trupi gjykues çmon se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, në vlerën 1.582.287 lekë²⁶ dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për personat e lidhur, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*, pasi ka shmangur nga deklarimi pasuritë e familjarëve të tij duke pamundësuar kontrollin e pasurive dhe interesave privatë të tyre.
53. Kolegji e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se analiza financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të rezulton me balancë negative për vitet 2009, 2014 dhe 2015, dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
54. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ervin Beqiri nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme. Për pasojë, bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, vendimi nr. 516, datë 03.03.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

²⁵ Komisioni tek të ardhura/fitimi nga Personi Fizik “Xh. B.” në vitin 2015, fitimit të konfirmuar nga DPT-ja i ka zbritur vlerën 600.000 lekë të faturave që mbajnë datën 30.12.2015, por që janë kaluar më 05.01.2016, duke ia shtuar këtë vlerë vitit 2016. Në vitin 2015 ka konsideruar vlerën 736.329 lekë, ku nga të ardhurat prej 1.336.329 lekësh ka zbritur vlerën 600.000 lekë dhe në vitin 2016 ka konsideruar vlerën 3.088.540 lekë, ku të ardhurave prej 2.488.540 lekësh i ka shtuar vlerën 600.000 lekë.

²⁶ Sipas analizës në paragrafët 49 dhe 50 të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 516, datë 03.03.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 28.03.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi